



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 184 Prot.

Gjirokastër, më 05/02/2020

V E N D I M

Nr. 10 , datë 05.02.2020

MIRATIMI I HAPJES SË PROGRAMEVE TË REJA,
NË UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Në zbatim të ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë ", neni 38 pika dh, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër neni 14 pika 6 dhe pika 9, vendimit nr. 879 datë, 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 18.12.2018 , të Këshillit të Ministrave "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë " dhe udhëzimit nr. 1, datë 14. 01. 2020 për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësave kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë " Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej , në mbledhjen e tij të datës, 05. 02. 2020;

V E N D O S I :

1. Në zbatim të akteve të reja nënligjore, vendimit nr. 879, datë 18.12.2019 dhe udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020, të cilat përcaktojnë elementë të rinj për aplikim për programe të reja të studimit, senati akademik i UGj-së, miraton shfuqizimin e **vendimit nr. 25, datë 08.11.2019**, miratimi i hapjes së programit të dyfishtë të studimit në ciklin e dytë në bashkëpunim me Universitetin e Maçeratës – Itali , " Master i Shkencave" në Arkeologji, Histori dhe Administrim i Pasurive Kulturore – ASPIC dhe shfuqizimin e vendimit **nr. 03, datë 09. 01. 2020**, miratimi e hapjes i programit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në Financë – Kontabilitet.

2. Të miratojnë hapjen e programeve të reja të studimit si më poshtë:
- a. Programin e dyfishhtë të studimit të universitetit “Eqrem Çabej” me universitetin e Maçeratës - Itali, në ciklin e dytë **“Master i Shkencave” në Arkeologji, Histori dhe Administrim i Pasurive Kulturore – ASPIC**, i cili do të realizohet në 2 (dy) vite akademike me 120 ECTS në sistemin me kohë të plotë i cili do të ofrohet nga departamenti i Historisë dhe Gjeografisë në njësinë kryesore Edukimit dhe Shkencave Shoqërore.
 - b. Programin e studimit të ciklit të dytë **“Master i Shkencave” në Financë – Kontabilitet**, ofruar nga departamenti i Kontabilitet – Financës në njësinë kryesore Ekonomik, i cili do të realizohet me 120 ECTS në 2 (dy) vite akademike.
 - c. Programin e studimit të ciklit të dytë **“Master Profesional ” në Shkencat Infermierore**, ofruar nga departamenti i Infermierisë në njësinë kryesore të Shkencave të Natyrës, i cili do të realizohet me 60 ECTS , në 1 (një) vit akademik.
 - d. Programin e studimit me karakter profesional 2-vjeçar **“Asistent - Menaxher në Mbrojtje Mjedisë”**, ofruar nga departamenti i Biologji – Kimi në njësinë kryesore të Shkencave të Natyrës, i cili do të realizohet me 120 ECTS, në 2 (dy) vite akademike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe një kopje e këtij vendimi i kalon Bordit të Administrimit për miratim.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK


Prof. dr Bektash MEMA

